



**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

263 QYTETARË TË INFEKTUAR ME COVID-19 NË 24 ORËT E FUNDIT

# INSTITUCIONET U BËJNË THIRRJE QYTETARËVE TË VAKSINOHEN



Me rritjen e numrit të rasteve të infektiveve me variantin "Delta" të koronavirusit, janë shtuar edhe thirrjet e institucioneve për qytetarët që të vaksinohen.

Ministria e Shëndetësisë të hënën ka ftuar qytetarët mbi moshën 18 vjeç që të vaksinohen kundër Covidit. Të njëjtën thirrje e ka bërë edhe ambasada

e ShBA-së në Prishtinë. Sipas tyre, vaksinat që ka Kosova janë të sigurta dhe parandalojnë simptomat e rënda të sëmundjes dhe vdekjen nga Covid-19

## AKTUALE



**META DEKORON ME MEDALJEN "NDERI I KOMBIT" DRITON KUKËN, NORA GJAKOVËN DHE DISTRIA KRASNIOQIN** F. 2

**BREGDETI SHQIPTAR MË I PËLQYERI, FLUKS I MADH NË KUFIRIN KOSOVË - SHQIPËRI** F. 3

**PARAQITET RASTI I PARË I ETHEVE TË MINJVE NË KOSOVË** F. 7

## EKONOMI

**ZKA-ja RENDITET NË MESIN E 17 INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT ME PAVARËSI TË LARTË NË BOTË** F. 8

**ATK-ja DËNON 62 KOMPANI PËR MOSPAJISJE ME ARKË FISKALE DHE MOSLËSHIM TË KUPONIT FISKAL** F. 8



## SPORT

**"ART MOTION" DHE "KLAN KOSOVA" MARRIN TË DREJTËN TELEVIZIVE TË SUPERLIGËS** F. 12

**Kusari-Lila: 'Ballkani i hapur' është nismë e dëmshme** F. 3



**Shuhen disa vatra të zjarreve në Kosovë** F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Meta dekoron me medaljen “Nderi i Kombit” Driton Kukën, Nora Gjakovën dhe Distria Krasniqin

**TRANË, 9 GUSHT** - Presidenti Shqipërisë, Ilir Meta, ka prituri në takim kampionet olimpikë Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova si dhe trajnerin e tyre Driton Kuka. Me këtë rast, Meta i ka dekoruar kampionet olimpikë dhe trajnerin e tyre me dekoratën

e lartë “Nderi i Kombit”. Presidenti Meta ka thënë se kampionet në fjalë personifikojnë më së miri ëndrrat, suksesin dhe krenarinë e popullit dhe të shtetit të Kosovës. “Nora dhe Toni, ashtu si më herët edhe kampionia tjetër Majlinda

Kelmendi, një meritë të jashtëzakonshme kanë edhe për lartësimin e krenarisë dhe të dinjitetit kombëtar, si shembuj të shkëlqyer frymëzimi dhe referimi për brezat e rinj në rrugën drejt suksesit”, ka shkruar Meta në llogarinë e vet në “Facebook”.



## Mbi 2 000 të evakuuar nga zjarret në ishullin Evia të Greqisë



**ATHINË, 9 GUSHT** - Autoritetet greke po vazhdojnë përbaljen me zjarre në ishullin Evia. Më shumë se 2 000 njerëz tashmë janë evakuuar. Zyrtarët lokalë thanë se disa pjesë të ishullit tashmë janë shkatërruar derisa u ankuan se nuk ishte dërguar ndihmë e mjaftueshme për t'i shuar zjarret.

Kryetari i qytetit Istiaia në ishullin Evia, Giannis Kontzias,

ka theksuar për mediat lokale se “tashmë është shumë vonë, zona është shkatërruar”.

Greqia po përballet me valën e saj më të rëndë të të nxehtit në 30 vjetët e fundit. Temperaturat kanë shkuar deri në 45 gradë celsius (113F).

Gjatë ditëve të fundit zjarre ka pasur edhe në rajone të tjera të Greqisë. Një zjarr në periferinë veriore të Athinës thuhet se

është shuar.

Ekspertët thonë se vala e nxehtësisë po bëhet më e mundshme dhe më ekstreme për shkak të ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga njerëzit.

Me një situatë të tillë gjatë kësaj periudhe janë përballur edhe vendet e tjera, përfshirë Turqinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

## Arabia Saudite kompenson familjet e punëtorëve shëndetësorë që vdiqën me koronavirus

**RIAD, 9 GUSHT** - Arabia Saudite ka nisur të ndajë nga 133 000 dollarë për familjet e secilit punëtor shëndetësor që ka vdekur duke luftuar pandeminë e koronavirusit, ka raportuar media shtetërore. Në njoftimin për media është thënë se qeveria do të ndajë këto shuma parash për familjet e të punësuarve në sektorin shëndetësor, qoftë në atë publik, privat, civil, ushtarak, saudit,

apo josaudit brenda Arabisë Saudite.

Agjencia shtetërore e lajmeve SPA ka thënë se punëtorët shëndetësorë “kanë dhënë jetën në luftën kundër pandemisë për ta ruajtur shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve dhe banorëve të Mbretërisë Saudite”. Ky shtet ka raportuar 8 320 viktima me koronavirus, mirëpo Ministria e Shëndetësisë nuk ka bërë publike shifrat e viktimave

në mesin e punëtorëve shëndetësorë. Arabia Saudite, me popullsi prej 30 milionë banorëve, ka thënë se ka dhënë rreth 30 milionë doza të vaksinave dhe aktualisht është duke raportuar më pak se 1 000 raste të të infektuarve në ditë. Prej shpërthimit të pandemisë, ky vend ka regjistruar rreth 533 000 raste me koronavirus.

Vdekja e parë është regjistruar më 2 mars të vitit 2020.



## Së paku 51 të vrarë në Mali



**GAO, 9 GUSHT** - Guvernatori i rajonit Gao në Mali ka thënë se të paktën 51 persona u vranë kur militantët islamikë bastisën tre fshatra. Shtëpitë u plaçkitën dhe u dogjën dhe tufat e bagëtive u morën me vete, raporton “Reuters”.

Zona gjendet në Malin qendror pranë kufirit me Nigerin.

Asnjë grup nuk ka marrë ende përgjegjësinë për sulmet në zonën ku trupat maliane, forcat franceze dhe evropiane dhe paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara po luftojnë kundër kryengritësve të lidhur me Shtetin Islamik dhe Al-Kaidën. Sulmet janë konfirmuar edhe nga zëdhënësi i ushtrisë së Malit, koloneli Souleymane Dembele, por ai nuk ka dhënë detaje të tjera.

Burime të tjera lokale i thanë

“Reuters”-it se militantët u vendosën në hyrjet e qyteteve dhe qëlluan mbi civilët.

Franca, një ish-fuqi kolonizuese, është vendi i vetëm perëndimor që ka prani të konsiderueshme ushtarake në Mali, ku po zhvillohen operacione kundër militantëve. Në vitin 2012 militantët pushtuan pjesën veriore të këtij shteti.

Ushtria franceze i ka dëbuar ata më 2013, prandaj mbi 4 000 trupa franceze vazhdojnë të jenë në Mali.

Një marrëveshje paqeje e nënshkruar më 2015 nga Qeveria e Malit dhe grupet e armatosura ka pasur synim rikthimin e stabilitetit në këtë shtet, mirëpo të gjitha paktet kanë dështuar ta ndalin dhunën e militantëve islamikë.

# Bregdeti shqiptar më i pëlqyeri, fluks i madh në kufirin Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 9 GUSHT - Sezoni turistik ka shkaktuar fluks të lëvizjeve në kufirin Shqipëri - Kosovë. Nga të dyja palët po punohet me procedurë të përsheptuar për shkak se hyrjet dhe daljet në të dy vendet janë të larta. Fluks i jashtëzakonshëm është raportuar që në orët e para të mëngjesit të ditës së hënë, pasi qytetarët e Kosovës i janë drejtuar bregdetit shqiptar për të pushuar.

Vetëm në fundjavën që lamë pas më shumë se 50 mijë qytetarë të Kosovës u nisën drejt Shqipërisë. Shumë prej qytetarëve të Kosovës kanë

kërkuar zbatim praktik dhe shmangie të vonesave, ndërsa ka prej tyre që duan edhe heqjen e traut në Rrugën e Kombit. Por radhët e gjata të automjeteve, si pasojë e fluksit të lartë, nuk krijohen vetëm në Morinë. Një tjetër segment problematik i Rrugës së Kombit është tek Ura e Drinit në hyrje të Kukësit. Radhë dhe vonesa krijohen edhe si pasojë e ngushtimit të rrugës me një sens lëvizje. Policia rrugore e stacionuar pranë këtij segmenti është duke menaxhuar trafikun për përpjekje për ta lehtësuar qarkullimin.



## Kusari-Lila: 'Ballkani i hapur' është nismë e dëmshme

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 GUSHT - Shefja e grupit parlamentar e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se të gjitha partitë në Kosovë kanë shprehur kundërshtitë e tyre për iniciativën "Ballkani i hapur" (Open Balkans) pasi, sipas saj, kjo nismë është e "dëmshme" për faktin se Serbia është bosht i kësaj iniciative. "Për ne absolutisht ka qenë një

proces që prej fillimit nuk është mbështetur dhe e kemi konsideruar si një proces paralel dhe të dëmshëm në momentin kur Serbia bëhet bosht i një iniciative, siç është rasti i 'mini-Shengenit' dhe (tani) 'Open Balkans', ka thënë Kusari-Lila pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Iniciativa "Ballkani i hapur" është vazhdimësi e "mini-Shengenit" ballkanik që Kosova e ka kundërshtuar edhe më

parë. Në këtë nismë, që është thënë se do të kontribuojë në krijimin e një tregu të përbashkët rajonal, bëjnë pjesë Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Kusari-Lila ka theksuar se kjo nismë s'mund ta ketë një emërtim të tillë, pasi kundërshtohet nga tri vende të Ballkanit Perëndimor. "Konsiderojmë që shumë më shumë fokus duhet t'u jepet pengesave të deritashme që janë bërë sesa iluzioneve se mund të ndryshojë i njëjti shtet

në raport me ne ose në raport me shtetet e tjera në Ballkan. Nuk jemi i vetmi shtet që refuzon 'Open Balkans'. Prandaj, nuk mund të quhet si i tillë derisa tri nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor e kundërshtojnë iniciativën", ka deklaruar Kusari-Lila. Ideja e "mini-Shengenit" është paraqitur në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019 nga liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Më 29 korrik 2021, kur iu

ndryshua emri kësaj nisme, në një forum ekonomik të mbajtur në Shkup, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ai i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u bënë thirrje të gjitha shteteve të rajonit që t'i bashkohen kësaj iniciative.

Në Marrëveshjen e Uashingtonit, të nënshkruar më 4 shtator 2020 në Shtëpinë e Bardhë, Kosova ishte zotuar se do të bëhej pjesë e "mini-Shengenit".

## Ambasadorët e shkarkuar kthehen në fund të muajit

PRISHTINË, 9 GUSHT - Fundi i këtij muaji është afati kur 12 ambasadorët e Kosovës nëpër vende të ndryshme të botës të shkarkuar në maj të këtij viti

duhet të kthehen në vend. Zëvendësimi i tyre tashmë është çështje ditësh. Kështu ka bërë me dije Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në

një përgjigje për "Klan Kosova", ku thuhet se ky proces do të mbyllet brenda pak ditësh. Grupi për Studime Juridike dhe Politike që e ka përcjellë këtë

proces diplomatik, kërkon nga ekzekutivi që emërimet e reja të jenë me integritet të lartë profesional dhe të mos jenë të lidhur me parti politike.





263 QYTETARË TË INFEKTUAR ME COVID-19 NË 24 ORËT E FUNDIT

# Institucionet u bëjnë thirrje qytetarëve të vaksinohen

Me rritjen e numrit të rasteve të infektive me variantin “Delta” të koronavirusit, janë shtuar edhe thirrjet e institucioneve për qytetarët që të vaksinohen. Ministria e Shëndetësisë të hënën ka ftuar qytetarët mbi moshën 18 vjeç që të vaksinohen kundër Covidit. Të njëjtën thirrje e ka bërë edhe ambasada e ShBA-së në Prishtinë. Sipas tyre, vaksinat që ka Kosova janë të sigurta dhe parandalojnë simptomat e rënda të sëmundjes dhe vdekjen nga Covid-19

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 9 gusht - Ministria e Shëndetësisë dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë u kanë bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të vaksinohen me vaksinat kundër Covidit. Sipas tyre, vaksinat që ka Kosova janë të sigurta dhe efektive.

Ministria e Shëndetësisë të hënën ka ftuar qytetarët mbi moshën 18 vjeç që të vaksinohen. “Me rritjen e përhapjes së variantit Delta të SARS-CoV-2 Ministria e Shëndetësisë inkurajon dhe u bënë thirrje të gjithë qytetarëve mbi 18 vjeç, e që ende nuk janë vaksinuar, të caktojnë sa më parë terminin për vaksinim dhe ata që kanë marrë dozën e parë, të paraqiten sipas orarit të caktuar në qendrën e vaksinimit për t’u vaksinuar plotësisht”, është thënë në njoftimin e Ministrisë së

Shëndetësisë.

Kjo ministri ka bërë me dije se vaksinat që ka Kosova janë të sigurta dhe efektive, duke shtuar se parandalojnë simptomat e rënda të sëmundjes dhe vdekjen nga Covid-19. “Aktualisht, vaksinimi po vazhdon me intensitet të shtuar që vërtet na inkurajon. Numri i qytetarëve që po vaksinohen në baza ditore konfirmon organizimin dhe punën e mirë të profesionistëve shëndetësorë nëpër pikat e vaksinimit”, ka vlerësuar MSh-ja. Edhe Ambasada Amerikane në Prishtinë ka ftuar qytetarët e Kosovës që të vaksinohen. Sipas kësaj ambasade, vaksinat kundër Covidit janë të sigurta dhe efektive. “Vaksinat janë të sigurta, efektive dhe zvogëlojnë ndjeshëm mundësinë që ju ose një anëtar i familjes të përfundoni në spital”, është thënë reagimin e Ambasadës së ShBA-së. Po ashtu,

edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që t’i përgjigjen fushatës së imunizimit kundër Covid-19. “Me vaksinim do ta kalojmë valën e re nga varianti ‘Delta’ me sa më pak të sëmurë e sa më pak viktime”, thuhet në një postim të IKShPK-së në rrjetin social “Facebook”.

## Edhe 263 raste të reja me koronavirus

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 263 raste të reja të infektimit me koronavirus. Gjatë kësaj periudhe kohore nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes. “Nga 3 008 testime, 263 qytetarë kanë dalë pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shënuar 8 qytetarë, kurse numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 105 765. Në total numri i rasteve aktive është 2 271”, është thënë në njoftimin e ministrisë. Për shkak të rritjes së rasteve të infektimit me Covid-19, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka paralajmëruar se qeveria do ta shqyrtojë mundësinë vendosjes së masave të reja për ta parandaluar përhapjen e pandemisë.

Në fund të javës së kaluar ai ka thënë se nga e hëna është në kontakt me të gjithë aktorët për masat e reja që pritet të merren në vijim. “Nga e hëna jemi në kontakte për masat e reja. Tanimë ka vaksina mjaftueshëm dhe nuk ka asnjë arsye që qytetarët të mos vaksinohen. Virusit ‘Delta’ nuk kursen as fëmijët. Janë shumë fëmijë të infektuar dhe ky është një alarm për të gjithë qytetarët që të jenë të ndërgjegjshëm”, ka thënë Vitia.

Ndërsa Oda e Hotelierisë dhe Turizmit (OHT) ka treguar se me ministrin Vitia janë pajtuar që nga 20 gushti çdo qytetar i Kosovës në mënyrë që të marrë pjesë në ndonjë aktivitet shoqëror, qoftë qendër tregtare, klube të natës apo në ahengjet familjare, obligohet që ta marrë vaksinën

kundër Covidit. “Çdo qytetar i Kosovës në mënyrë që të marrë pjesë në çdo aktivitet shoqëror, qoftë qendër tregtare, klube të natës apo në ahengje familjare, obligohet që ta marrë vaksinën kundër Covidit, sepse nga data 20 gusht do të kërkohet që të paktën dozën e parë ta kenë të përfunduar, përndryshe nuk mund të marrin pjesë në asnjë aktivitet. Ndërsa sa i përket stafit punues të këtyre sektorëve, obligohen që deri më 12 gusht ta përfundojnë të paktën dozën e parë të vaksinimit.”, është thënë në njoftim e OHT-së.

Numri i rasteve ka filluar të rritet në pjesën e dytë të muajit korrik, kur janë liruar pothuajse të gjitha masat kundër Covidit. Institucionet shëndetësore kanë bërë me dije se 80 për qind e rasteve të reja janë të infektuar me variantin “Delta”. Deri më 9 gusht në Kosovë janë administruar 492 801 doza të vaksinës kundër koronavirusit, kurse 167 912 qytetarë janë vaksinuar me të dyja dozat e vaksinës. Megjithatë, jo të gjithë përkrahin dëshminë e vaksinimit për të marrë pjesë në aktivitete shoqërore si ahengje familjare, qendra tregtare, restorante dhe klube nate.

# Krasniqi në Drenas: Ramiz Lladrovci është lokomotivë e zhvillimit që e duan të gjithë qytetarët



**DRENAS, 9 GUSHT (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka qëndruar të hënën në Drenas, ku në stadiumin e qytetit "Rexhep Rexhepi" ka paraqitur kandidatin e PDK-së për kryetar të ardhshëm të Drenasit, Ramiz Lladrovci. Krasniqi ka thënë se për 20 vjet me radhë Partia Demokratike e Kosovës dhe Drenasi kanë rrugëtuar bashkë, në ditë të mira e në ditë të vështira, por kurrë nuk janë

ndalur. Lideri i opozitës ka thënë se me qeverisjen e PDK-së, Drenasi, i cili ndodhet në zemër të Kosovës, ka përjetuar zhvillim të hovshëm e transformim për të vazhduar me sukses rritjen e perspektivës ekonomike për të gjithë qytetarët. "E di se kurrë nuk është mjaftueshëm dhe ka shumë për t'u bërë, por është për çdo ditë më mirë se që ka qenë. E unë ju zotohem sot, se do të bëhet shumë më mirë se që

është. Merita për këtë ka gjithsecili prej jush. Gjithsecili qytetar. Por, pa dyshim, se meritë të madhe ka kryetari Ramiz Lladrovci, i cili jo veç që ka qeverisur, por ka qeverisur mirë. Qeverisja e tij është vlerësuar si model edhe nga institucionet qendrore të Republikës, për çka ne jemi krenarë. Por shumë më e rëndësishme se kaq është vlerësimi i qytetarëve të Drenasit. Besimi i tyre. Vullneti i tyre për zhvillim", ka thënë

Krasniqi. Ai ka folur në Drenas edhe për profilin e kryetarit Ramiz Lladrovci që e kanë vlerësuar të gjitha instancat mbikëqyrëse të qeverisjes lokale, por edhe për dimensionin kombëtar e kontributin e tij dhe familjes së tij për çlirim. "Ai është bashkëluftëtar i Adem Jasharit e bashkorganizator i ditëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mik e bashkudhëtar në rrugën e lirisë me dy ish-liderët tanë,

Hashim Thaçin e Kadri Veselin. Jo vetëm vëlla, por bashkëluftëtar i heronjve të kombit Fehmi e Xhevë Lladrovci, Rasim Kiçina e qindra dëshmorëve të UÇK-së. Njeriu juaj, ai që ia do të mirën Drenasit e që me të në krye të Drenasit do të bëjmë punë që do të na qesin faqebardhë. Ramiz Lladrovci jo veç që është alternativë, por edhe lokomotivë e zhvillimit që na pret. Ky është zotimi i tij. Ky është zotimi i PDK-së", ka thënë Krasniqi.

## Dedaj takon në Tetovë Ali Ahmetin, ia dhuron portretin e Adem Jasharit

**TETOVË, 9 GUSHT** - Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka takuar të hënën liderin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmetin. Dedaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar që takoi në selinë e BDI-së

në Tetovë, Ali Ahmetin. "Me këtë rast liderit Ali Ahmeti ia dhurova portretin e komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, i cili heroikisht ra dëshmor, me dhjetëra familjarë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka shkruar Dedaj.



## Lushtaku paraqet projektin për rregullimin e qendrës së Runikut

SKENDERAJ, 9 GUSHT (ER) - Kandidati për kryetar të komunës së Skenderajt nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Sami Lushtaku, ka mbajtur takim me banorët e fshatit Runik. Ai ka paraqitur projektin për rregullimin e qendrës së Runikut. "Runiku si

vendbanim i lashtë është qendër e trashëgimisë kulturore në Skenderaj, në të cilin ndër shekuj është zhvilluar civilizimi. Runiku daton që nga koha e civilizimit iliro-dardan. Para qytetarëve të bashkësisë lokale të Runikut paraqita projektin për rregullimin e qendrës së

Runikut i cili bashkë me Likofcin do të jenë ndër prioritetet e para gjatë qeverisjes sime në krye të komunës së Skenderajt", ka thënë Lushtaku. Ai ka theksuar se Runiku do të trajtohet ashtu siç e meriton pasi, sipas tij, historia e trashëgimisë kulturore është vlerë për gjithë këtë zonë.



## QKMF-ja në Malishevë pajiset edhe me një autoambulancë



MALISHEVË, 9 GUSHT (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Malishevë "Dr. Shpëtim Robaj" është pajisur edhe me një autoambulancë të re për nevojë të përditshme të tyre. Kjo autoambulancë është siguruar nga buxheti i komunës së Malishevës, ndërsa automjetin për QKMF-në e ka dorëzuar nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, kurse pranimiti është bërë nga u. d. i drejtorit të QKMF-së, dr. Afrim Krasniqi. "Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për pacientët e komunës sonë e më gjerë është shumë i rëndësishëm, prandaj pajisja me mjete pune për QKMF-në është dhe do të jetë gjithmonë prioritet, sepse me këtë e mbrojmë shëndetin e popullatës. Edhe ky automjet i ndihmës së parë hyn në

këtë funksion, që pacientit t'i ofrohet ndihma në çdo çast dhe në çdo vend", ka thënë nënkryetari Berisha me rastin e dorëzimit të automjetit dhe ka uruar që të kenë sa më pak punë. Ndërsa ushtruesi i detyrës i drejtorit të QKMF-së, dr. Afrim Krasniqi, e ka falënderuar komunën për këtë investim, tepër domethënës për punën e tyre. "Pajisja edhe me një autoambulancë do të thotë shumë për ne, pasi na lehtëson punën dhe na mundëson kryerjen e shërbimeve më të shpejta për të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmë mjekësore", ka thënë Krasniqi, i cili ka sqaruar se tashmë QKMF-ja në Malishevë i ka në dispozicion gjashtë autoambulanca.

## Policia zbaton planin "Gastronomia", shqipton gjoba për dhjetëra lokale të gastronomisë dhe klube të natës

FERIZAJ, 9 GUSHT (ER) - Në zbatim të vendimit të ri të Qeverisë së Kosovës, Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj, për dy ditë radhazi, në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës, inspektorët e komunës së Ferizajt, e mbështetur edhe nga Njësia e Reagimit të Shpejtë dhe Njësia Speciale e Policisë së Kosovës, ka realizuar planin operativ "Gastronomia", në zbatim të masave Covid-19. Në zbatim të këtij plani janë kontrolluar dhjetëra lokale të gastronomisë dhe klube të natës në Ferizaj. "Angazhimet policore janë duke vazhduar në bashkërendim edhe

me mekanizmat e tjerë ndërinstucionalë, ku i gjithë ky angazhim ka reflektuar si masë parandalimi dhe ngritje e nivelit të respektimit të këtyre masave. Policia, me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për respektimin e masave, do t'i shtojë kontrollet në lokalet e gastronomisë", ka njoftuar Policia e Kosovës, duke theksuar se Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj falënderon qytetarët, pronarët e lokaleve që në masë të madhe po i respektojnë këto masa. Gjithashtu, bën thirrje për respektimin e këtyre masave nga të gjithë, në të mirë të shëndetit publik.



## 100 fermerë të Mitrovicës do të përkrahen për dëmet që kanë pësuar nga vërshimet

MITROVICË, 9 GUSHT (ER) - Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën e Mitrovicës, Ekrem Sadiku, ka bërë me dije se është në përfundim të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në këtë komunë. Sipas tij, janë më shumë se 100 fermerë të cilët Ministria e Bujqësisë do t'i kompensojë me

30 për qind të vlerës së dëmeve. Në mbledhjen e bordit të drejtorëve ai i ka njoftuar drejtorët komunalë edhe lidhur me projektet të cilat janë në realizim e sipër në këtë drejtori. "Komuna e Mitrovicës së bashku me IADK-në dhenë mbështetje të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë do të mbajnë trajnime profesionale për aftësim

profesional për 45 punëkërkes, ku 15 fermerë kanë mundësinë të mbështeten financiarisht me grante në vlerë 3 000 euro (vetëpunësim) dhe 5 000 euro (start-up). Po ashtu, projekti për hapjen e puseve në bashkëpunim me organizatën 'Charar Charity'. Sipas këtij projekti, do të hapen afër 50 puse", ka theksuar drejtori Sadiku.



# Paraqitet rasti i parë i etheve të minjve në Kosovë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se është duke e përcjell situatën epidemiologjike me ethet e minjve, ku për çdo vit paraqiten raste sporadike, të cilat në Kosovë janë të përhapura në rajonin e Dukagjinit, rajonin e Karadakut dhe rajonin e Shalës. Sipas këtij instituti, sivjet është paraqitur rasti i parë i etheve të minjve. "Ruani ushqimet nga minjtë. Mos përdorni fruta mali të palara sepse mund të sëmureni nga ethet e minjve. Kujdes! Varësisht nga shumimi i minjve, në laboratorët e mikrobiologjisë diagnostikuar rastin e parë sivjet me ethe të minjve. Burim i infeksionit

janë minjtë. Sëmundja përhapet me ushqim, me aerosole dhe me kontakt. Rastet me ethe hemorragjike me sindromën renale sporadike janë të palidhura mes vete dhe nuk ka ndonjë shpërthim epidemik mes tyre, por pakujdesi gjatë ruajtjes së ushqimit dhe konsumimi i manave të palara mund të shkaktojë sëmundje vdekjeprurëse", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas IKShPK-së, trajtimi i sëmundjes bëhet me sukses të plotë në Klinikën Infektive në qoftë se rastet paraqiten me kohë. "Nëse të sëmurët kërkojnë ndihmë me vonesë paraqiten komplikime, e që mund të bllokohen veshkat. Klinika Interne, gjegjësisht repartet e dializës, janë të gatshme që të hemodializojnë përkohësisht

pacientët. Ndërsa Instituti Kombëtar me laboratorët e vet e diagnostikon sëmundjen brenda ditës", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ky institut ka njoftuar për njëmbëdhjetë masat parandaluese ndaj etheve të minjve: 1. Pengimi i futjes së brejtësve në shtëpi dhe stane; 2. Ruajtja e ushqimit nga ekskretet e brejtësve; 3. Përpunimi termik i artikujve ushqimorë të dyshimtë; 4. Frytjet e pyllit mos të konsumohen pa u pastruar; 5. Djathit të freskët t'i shtohet kripë dhe mos të konsumohet si i freskët nëse dyshohet se është kontaminuar; 6. Gjatë punës në fushë të punohet me maska nëse vërehet shtim i brejtësve; 7. Larja e duarve me ujë dhe sapun te kosarët dhe punëtorët e tjerë të fushës para ngrënies; 8. Mos hidhni mbeturina kudo;



9. Të bëhet klorimi i ujit të pijes; 10. Zhdukja e vatrave natyrore të brejtësve; dhe 11.

Dezinfektimi i sipërfaqeve të kontaminuara nga ekskretet e brejtësve.

## Të enjten mbahet seanca e fundit e sesionit pranveror

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 GUSHT - Këtë të enjte do të mbahet seanca plenare e radhës. Kështu vendosi të hënën Kryesia e Kuvendit të Kosovës, e drejtuar nga kryeparlamentari Glauk Konjufca. Fillimisht në orën 10:00 Kuvendi do të procedojë me tri pikat e mbetura nga seanca e mbajtur më 6 gusht 2021 për të vazhduar më pas me seancën e re. Kështu, pas ezaurimit të dy pikave të zakonshme, deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi pritet ta shqyrtojë Projektligjin nr. 08/L-024 për ratifikimin e Amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze në lidhje me Programin Kornizë për



bashkëpunim financiar, si dhe ta zgjedhë Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së

Kosovës. Seanca do të vazhdojë me shqyrtimin e raporteve vjetore

(për vitin 2020) të pesë institucioneve të pavarura: Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës, Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, si dhe të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2020. Kjo seancë, e cila pritet të jetë e fundit për këtë sesion, do të përmbyllet me shqyrtimin e propozimit të grupit parlamentar të Listës Serbe për zëvendësimin e anëtarit në komision parlamentar.


Në këtë mbledhje, kryesia, në përputhje të rekomandimit të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, ka miratuar raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2021, si dhe ka shqyrtuar çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.

## Shuhen disa vatra të zjarreve në Kosovë

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) ka njoftuar të hënën për situatën e zjarreve në Kosovë. Sipas kësaj agjencie, gjendja në terren paraqitet e menaxhueshme nga strukturat operative për zjarrfikje dhe shpëtim në të gjitha komunat e Kosovës. "Numri i zjarreve në tërë territorin e vendit është në rënie, ndërsa kërcënim serioz mbetet zjarri i shpërfaqur nga

data 5 gusht 2021 në komunën e Vitisë, Fshati i Ri, ku veprojnë të gjitha kapacitetet në dispozicion të komunës përkatëse, ndërsa ndihmë u kanë ofruar edhe komunat fqinje si Gjilani, Ferizaj dhe Kamenica. Situata në parkun nacional Bjeshkët e Nemuna, lokacioni Shtupe, është e menaxhueshme nga kapaciteti lokal", ka njoftuar Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

Si pasojë e reagimit të Njësitë Profesionale të Zjarrfikës dhe Shpëtimit (NJPZSH) është raportuar për disa lëndime trupore të zjarrfikësve por, fatmirësisht, jo me rrezik për jetë. Agjencia e Menaxhimit Emergjent u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës për kujdes të shtuar që, në periudha të ngritjeve të temperaturave, ta shmangin ndezjen e zjarreve.



# ZKA-ja renditet në mesin e 17 institucioneve supreme të auditimit me pavarësi të lartë në botë

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Besnik Osmani, ka mirëpritur gjetjet e raportit të Bankës Botërore lidhur me pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, duke vlerësuar se kjo e arritur e madhe është rezultat i punës profesionale dhe përkushtimit të personelit, përkrahjes nga publiku i Kosovës dhe ndihmës së partnerëve ndërkombëtarë. "Përfundimisht, shembulli i Zyrës Kombëtare të Auditimit është mesazhi më i qartë se Republika e Kosovës ka kapacitete për të ndërtuar institucione kredibile në rang botëror. Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është renditur në mesin e Institucioneve Supreme të Auditimit që gëzojnë pavarësi të lartë në botë. Raporti i Bankës Botërore 'Indeksi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit' ka listuar ZKA-në në mesin e 17 Institucioneve Supreme të Auditimit të cilat kanë pavarësi të lartë", ka njoftuar ZKA-ja.

Rezultatet e këtij raporti tregojnë se Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës dhe ajo e Kroacisë qëndrojnë më mirë se institucionet homologe të vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket pavarësisë institucionale. Ky vlerësim ka përfshirë 118 vende të botës dhe është bazuar në dhjetë indikatorë të pavarësisë, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira: Kushtetuta dhe korniza ligjore, transparenca në emërimin e kreut të ISA-ve, pavarësia financiare, llojet e auditimit, pavarësia operacionale, pavarësia e stafit, mandati i auditimit, pavarësia në fushëveprimin e auditimit, qasja në të dhëna dhe informata, të drejtat dhe përgjegjësitë në raportet e auditimit. Sipas raportit, vetëm 2 nga 118 vende u vlerësuan me 10 pikë, pra me pavarësi shumë të lartë; 17 vende kishin pavarësi të lartë; 33 vende kishin pavarësi thelbësore; 37 vende kishin pavarësi të kënaqshme dhe 29 vende kishin pavarësi të ulët.



# ATK-ja dënon 62 kompani për mospajisje me arkë fiskale dhe moslëshim të kuponit fiskal



PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se ka shqiptuar 1 429 gjoba për mospajisje me arkë fiskale dhe moslëshim të kuponit fiskal. "ATK-ja në funksion të luftimit të ekonomisë joformale gjatë këtyre ditëve ka inspektuar aktivitetin e sektorit të transportit rrugor ndërkombëtar. Gjatë këtyre inspektimeve zyrtarët e ATK-së kanë lëshuar 1 429 gjoba për mospajisje me arkë fiskale dhe moslëshim të kuponit fiskal te 62 kompani, të cilat janë përcjell për procedim në Zyrën për

Gjoka dhe Ndëshkime Administrative", është bërë me dije në njoftimin e ATK-së. ATK-ja ka theksuar se të gjitha këto aktivitete janë duke u ndërmarrë në kuadër të planit operativ të veprimit për periudhën korrik - shtator 2021, i cili është duke trajtuar edhe sektorë të tjerë. "ATK-ja gjatë ditëve në vijim do t'i inspektojë sektorët të cilët gjatë kësaj sezone kanë aktivitete të shumëfishuara dhe gjendja e tyre në relacion me obligimet tatimore nuk është në nivelin e duhur", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

## Festivali "AgroFesta 2021" vjen me "3 ditë t'gzueme"

RAHOVEC, 9 GUSHT (ER) - Festivali tradicional i perimekulturës në Krushë të Madhe, "AgroFesta", në edicionin e shtatë vjen me shumë aktivitete perimtare,


kulturore dhe rekreative. "AgroFesta" tash e disa vjet mbledh në Krushë të Madhe qytetarë të shumtë nga i gjithë vendi, të cilët vizitojnë Krushën e Madhe

dhe shohin nga afër përkushtimin e madh të krushjanëve dhe punën e tyre në prodhim të perimekulturave dhe produkteve të tyre. Sipas

njoftimit, festivali sivjet mbahet më 20, 21 dhe 22 gusht 2021. Festivali mbahet me përkrahjen e komunës së Rahovecit.







MARK TWAIN

# LUTJA E LUFTËS

Ishte koha e lavdishme e ngadhënjimit dhe ndjenjave të zjarra popullore. Vendi kishte rrokur armët, lufta vazhdonte, në çdo kraharor digjej zjarri i shenjtë i patriotizmit, trumbetat binin, orkestrat frymore gjëmonin, pisqollat shkreheshin si të ishin lodra, fishekzjarret fishkëllenin dhe shpërthenin në qiell; në duart e gjithkujt dhe në mizërinë e çative dhe ballkoneve të shtëpive dallgëzonte deti i flamujve shumëngjyrësh nën diell; rinia vullnetare bënte marshimin e përditshëm në shëtitoren e madhe, gazmorë dhe me uniformat e reja që u rrinin bukur, kurse etërit, nënat dhe motrat, bashkë me të dashurat krenare, brohorisnin me zërat që drithëroheshin nga lumturia duke kënduar; në mbledhjet e natës njerëzit shtynin njëri-tjetrin për të dëgjuar, duke gulçuar, nën ndikimin e oratorisë patriotike e cila trazonte shpirtat e çonte peshë zemrat, ndaj dhe herë pas here fjalimet ndërpriteshin nga stuhi duartrokitjesh, derisa lotët u shkisnin teposhtë faqeve; në kisha pastorët predikonin besnikëri ndaj flamurit dhe vendit, përmendnin Zotin e Luftës, duke u lutur për mbështetjen e Tij për kauzën tonë të mirë ndërsa gojëtarja e tyre e kulluar buçiste e trondiste këdo që dëgjonte.

Ishte me të vërtetë kohë e lumtur dhe e hirshme, dhe ato pak shpirtat të nxituar që guxuan të mos e praninin luftën e të vinin në dyshim drejtësinë e saj, morën aty për aty një paralajmërim kaq të rreptë dhe të inatosur sa për hir të sigurisë së tyre vetjake u tretën sysh dhe nuk fyen më asisoj.

Mëngjesi i të dielës mbërriti, të nesërmen batalionet do të niseshin për në front. Kisha ishte plot e përplot me njerëz; ishin vullnetarët aty, fytyrat e tyre rinore

ndriçonin nga ëndrrat me luftë - vegime të përparimit të palëkundur të trupave, mble-dhja e forcave, vrulli i sulmit, shpatat që vetëtinin, arratia e armikut, rropama e përlëshjes, tymnaja që ngruhej në qiell, ndjekja këmbakëmbës e të mundurve, dorëzimi i tyre, kthimi nga lufta në shtëpi, si heronj prej bronzi, të mirëpritur, të adhuruar, të zhytur në detin e artë të lavdisë!

Afër vullnetarëve ishin ulur të dashurit e tyre, krenarë, të lumtur ata shiheshin me zili nga fqinjët dhe miqtë të cilët s'kishin djem dhe vëllezër për t'i dërguar atje, në fushën e nderit, për të fituar për flamurin ose, nëse nuk ia dilnin dot, të kishin fatin të përjetonin më madhështoren ndër të gjitha vdekjet madhështore. Mesha vazhdoi; u lexua një kapitull për luftën e Testamentit të Vjetër; u bë lutja e parë; ajo u pasua nga një shpërthim i muzikës se një organoje që shkundi ndër-tesën dhe, sakaq, të gjithë u ngritën në këmbë, me vështrim krenar dhe zemrat që rrahin fort, ndërsa nga kraharorët gjëmoi thirrja e jashtëzakonshme:

“Zot, më i tmerrshmi Zot! Ti na urdhëron!

Trumbetat le të gjëmojnë! Shpatat të flakërojnë!

Pastaj ishte radha e lutjes “së gjatë”. Askush s'mbante mend diçka të ngjashme me atë lutje emocionale, prekëse dhe gjuhën e bukur që u përdor. Detyra e kësaj përgjërë ishte, që një atë gjithnjë i mëshirshëm dhe bujar me të gjithë ne, t'i ruante ushtarët tanë të rinj e fisnikë, t'i ndihmonte, t'ua lehtësonte mundimin, t'i nxiste për vepra atdhetare, t'i bekonte, t'i mbronte në ditën e betejës dhe orën e rrezikut, t'i mbante në

pëllëmbën e tij të fuqishme, t'i bënte të fortë dhe me vetë-besim, të pathyeshëm në fillimin e përgjakshëm; t'u ndihte ta shtypnin armikun, t'i jepte flamurit dhe vendit të tyre nderin dhe lavdinë e përjetshme.

Një i huaj në moshë të thyer hyri dhe eci me hapa të ngadaltë dhe pa zhurmë nëpër rreshtin kryesor, me sytë e ngulitur tek pastori. Mbi trup mbante një raso të gjatë deri te këmbët, flokët e thinjura që zgjateshin si shkurmajë e gufmuar mbi shpatulla, fytyra e krupshme dhe me zbehtësi të çuditshme, gati-gati si e një fantazme. Megjithëse sytë i të gjithëve e ndiqnin ndërsa pyesnin veten se kush ishte, ai u çapiti i heshtur; pa u ndalur, u ngjiti në anën e predikuesit dhe qëndroi atje duke pritur. Me sytë e mbyllur predikuesi, i pavetëdijshëm për praninë e tij, vazhdoi me lutjen e tij prekëse dhe, më në fund, e përfundoi me fjalët, e shqiptuara gjithë zjarr: “Bekoji armët tona! Jepna fitoren, o Zot. Perëndia ynë, Ati dhe Mbrojtësi i tokës dhe flamurit tonë!”

I huaji e preku në krah, i bëri me shenjë të hiqej mënjane. Ashtu bëri pastori i trembur dhe i huaji zuri vendin e tij. Për pak çaste këqyri me vështrim solemn audiencën e magjepsur, sytë i vetëtitnin me një dritë të çuditshme, pastaj me një zë kumbues tha: - Unë vij nga fronti dhe kam mesazhin e dërguar nga Zoti i Plotfuqishëm!

Fjalët e goditën kishën duke e trandur, por edhe pse i huaji e pikasi këtë efekt, nuk i kushtoi fare vëmendje.

Ai e ka dëgjuar lutjen e shërbëtorit të Tij, bariut tuaj, dhe do t'ia plotësojë nëse kjo do të jetë dëshira juaj pasi unë, i dërguari i Tij, t'ju shpjegoj domethënien e saj, domethënien e plotë. Sepse si

shumë lutje të njerëzve, kërkohet më shumë sesa ai që e thotë është i vetëdijshëm për çfarë kërkon, ngaqë nuk ndalet ta peshojë kuptimin. Shërbëtori i Perëndisë dhe juaji e tha lutjen e tij. Po a është ndalur ta peshojë? A është veç një lutje? Jo, janë dy, një e thënë, tjetra e pathënë. Të dyja kanë arritur në veshët e Atij që dëgjon të gjitha lutjet, të thënat dhe të pathënat. Mendojeni këtë, mos e harroni. Nëse kërkoni një bekim për veten, kini kujdes! Bëjeni pa qëllimin që lutja juaj të jetë mallkim për fqinjin. Nëse luteni për bekimin e shirave për të mbjellat e tua të cilat kanë nevojë, kjo lutje mund të jetë mallkim për të mbjellat e fqinjtit të cilit shirat mund t'ia kalbin ato.

Keni dëgjuar lutjen e shërbëtorit tuaj, pjesa e thënë me fjalë prej tij. Jam caktuar nga Zoti që ta shpreh me fjalë pjesën tjetër të lutjes, atë pjesë për të cilën pastori dhe, gjithashtu ju në zemrat tuaja, u lutet me shpirt në heshtje. Dhe pa e ditur dhe pa e menduar? Zoti më tha se kështu ishte! Dëgjuat këto fjalë: “Jepna fitoren, o Zot, Perëndia ynë!” Kaq mjafton. Tërësia e lutjes së shprehur me fjalë mishërohet në këto fjalë kuptimplota. S'kishte nevojë për stërhollime. Kur u lutët për fitore, ju u lutët për shumë pasoja të papërmendura pas fitores, detyrimisht ka pasoja, e pamundur të mos ketë. Në shpirtin dëgjimtar të Atit Perëndi mbërriti edhe pjesa e pashprehur e lutjes. Ai më porositi mua ta shpreh me fjalë. Dëgjomëni!

O Perëndi, Ati ynë, rinia atdhetare, idhujt e zemrave tona, po nisen për në betejë, qofsh Ti afër tyre! Bashkë me ta, edhe ne po braktisim paqen e ëmbël të ngrohtësisë kaq të dashur të vatrës familjare për ta dërrmuar armikun. O Perëndi, Ati ynë, na


ndihmo t'i bëjmë copë e çikë ushtarët e tyre me predhat tona; na ndihmo t'i mbulojmë fushat gjithë jetë me trupat e pajetë të patriotëve të tyre të vdekur; na ndihmo të mbytet gjëmimi i armëve nga britmat e të plagosurve të tyre në grahamat e dhimbjes; na ndihmo që shtëpitë e tyre bujare t'i fshijmë nga faqja e dheut me stuhi flakësh; na ndihmo që zemrat e vejjshave të tyre fisnike të plasnin prej pikëllimit që s'ka ngushëllim; na ndihmo t'i lëmë pa strehë mbi krye dhe vocërrakët e tyre të enden fillikat në rrënojat e tokës së shkretuar, me zhele në trup, të uritur dhe të etur, të pambrojtur përballë rrezeve përvëluese të diellit të verës dhe ciknave të akullta të dimrit, zemërthyer, të rraskapitur nga stërmundimi, ndërsa të përgjërohen Ty për qetësinë e varrit, por Ti ua mohon. Dëgjoje lutjen tonë për Ty, Perëndi që të adhurojmë dhe lëri të pashpresë, rrënojuat jetët. Qoftë i pafund pelegrinazhi i tyre plot vuajtje, hapat i paçin të rëndë! Ujite rrugën ku kalojnë me lotët që derdhin, përskuqë borën e bardhë me gjakun e këmbëve të plagosura! Ta kërkojmë, në frymën e dashurisë, Ty që je burimi i dashurisë, dhe Ty që je streha gjithnjë besnike dhe miku i të gjithë atyre që janë të lënduar dhe kërkojnë ndihmën Tënde me zemra të përulura dhe të penduara. Ashtu qoftë.

*(Pas një pushimi të shkurtër.)*

Këtë lutje bëte. Nëse ende dëshironi që kjo të ndodhë, flisni! Lajmëtar i Më të Lartit po pret!

Më vonë besohej se burri kishte genë i çmendur, sepse s'kishin kuptim ato që ai tha.

*Përktheu: Granit Zela*



CARLOS FUENTES

# MIQËSIA

Atë që ne nuk e kemi në veten tonë, e gjejmë në personin e mikut. Unë besoj në këtë dhuratë të miqësisë dhe kjo është ngulitur kështu qysh nga fëmijëria ime. Këtu unë s'ndryshoj aq shumë nga pjesa më e madhe e qenieve njerëzore. Miqësia është çimentoja e parë ndërmjet familjes dhe botës. Vatra familjare, e lumtur ose jo, është shkolla e mençurisë sonë zanafillore, por miqësia është prova e saj. Atë që e marrim nga familja, ne ia ripohojmë miqësisë.

Dallimet, kundërshtitë apo ngjashmëritë ndërmjet prindërve dhe miqve tanë, përçaktojnë drejtimet e ndryshme të jetëve tona. Edhe pse e duam vatrën tonë, të gjithë ne kalojmë nëpër atë çastin e shqetësuar, ose të paqëndrueshëm, të braktisjes (edhe kur ne e duam vatrën dhe gëlohemi mes saj). Braktisja e vatrës familjare ka si shpërblim vetëm miqësinë. Por ka edhe më tepër - pa miqësi, vatra do të shembej. Miqësia nuk e kundërshton familjen në

fillimet e jetës. Ajo i mbështet këto fillime, i forcon, i përzgjat. Miqësia ua hap udhën ndjenjave të cilat nuk mund të rriten ndryshe përveçse jashtë. Të mbyllura në shtëpinë familjare, ato do të thaheshin si bimët pa ujë. Me dyert dhe krahët të hapura, ne zbulojmë forma dashurie të cilat bashkojnë botën me vatrën. Këto forma kanë për emër miqësinë.

Meqë unë besoj në këtë vlerë fillestare të miqësisë, vëmendja më është ndalur mbi cinizmin filozofik, i cili e shoqëron miqësinë me një re të zezë. Oscar Wilde përdor dhuntinë e tij të tmerrshme për paradokse, kur thotë për Bernard Shawn që *ai nuk ka asnjë armik në botë, sigurisht, por puna është që asnjë prej miqve të tij nuk e do*. Për Byron, miqësia, fatkeqësisht, është vetëm dashuri pa flatra. Dhe nëse miqësia mund të shndërrohet në dashuri, është e sigurt që kjo e fundit tjetërsohet rrallë në miqësi. Urtësia popullore thotë se është mirë që miku të prit

me dorë në zemër, por të përcillet shpejt e shpejt. Nëse pas tri ditësh ai është ende në shtëpinë tuaj, atëherë ai do të shpërhapë erë, njëllonj si kufomat.

Mendoj se në miqësitë e humbura ka më tepër dhimbje sesa cinizëm. Kujtimi i ndjenjave të shpallura dhe të përbashkëta. Fillimet e shpresave të përbashkëta të rinisë sonë. Gëzimi i grupit, i klanit, i bandës, i ekipit, i vëllazërisë apo i shokëve. Lidhjet që thuren. Le të mësojmë për ta mposhtur sedrën e qenies - i ri. Një ditë ne nuk do të jemi të tillë dhe do të kemi nevojë - më tepër se kurrë - për miq.

Dy mosha hapin dhe mbyllin përvojën e miqësisë. E para është mosha e butë dhe "hard-disku" im fillon të shpëshpëtoj emra, fytyra, veprime dhe huqe shokësh. Por ajo për atë që unë kujtohem, nuk e kundërpeshon aspak atë që e kam harruar. Në të njëjtën kohë, e si të mos nderoj faktin që, edhe gjashtëdhjetë vjet më pas, kam

mbajtur lidhje me shokët e mi të parë të fëmijërisë - një fëmijëri endacake prej familje diplomatësh, një endje e cila nuk do të vazhdojë gjithmonë?! Mbjat ende letërkëmbim me Hans Berliner, një fëmijë çifut gjerman që erdhi në shkollën tonë filllore në Uashington. Ai i ikte terrorit nazist dhe shumë shpejt u bë objekt i mizorisë fëmijërore për shkak të dallimit nga të tjerët. Ishte brun, mjaft i gjatë për moshën e tij por, si të gjithë evropianët e vegjël të asaj kohe, mbante pantallona të shkurtra. Për fëmijët amerikanoveriorë, ai ishte *joregular*, domethënë jo si ata. Edhe unë e kam humbur popullaritetin tim fillestar kur presidenti Cardenas ka shtetëzuar naftën më 1938 dhe kur jam paraqitur - dhe kjo nuk qe hera e fundit në jetën time - si një komunist i bindur. Kështu, lëçitja na ka bashkuar të dyve, mua dhe atë, deri në ditën e sotme. Pastaj gjeografia na ka ndarë, por në Santiago të Kilit shpejt kam zbuluar gëzimet e ekipit - të shokëve dhe të miqve

- më të rinj që pëlqenin më tepër leximin dhe diskutimin sesa sportet e ashpra të llucës deri në gju të shkollës sonë angleze, *The Grange*, të ndërtuar nën këmbë të Andeve dhe të drejtuar nga ca kapitenë britanikë, të bindur që fitorja e Waterloosë ishte luajtur mbi terrenet e Etonit. Më kujtohen të gjithë emrat, të gjitha fytyrat: Page, Saavedra, Quesnay, Marin, sidomos Torretti, Roberto, shoku im letrar; si dy matadorë përballë të njëjtës dem, bashkë kemi shkruar romanin tonë të parë. Romani është zhdukur në sëndukët e pasurisë trashëgimore të nënës së Robertos, por ne kemi vazhduar të shkruajmë ende edhe sot, dhe i vazhdojmë bisedat tona me zë të lartë në Oaxaca apo në Porto Rico, si dhe dialogun tonë të shkruar ndërmjet Meksikës dhe Kilit. Ai është një filozof i veçantë dhe miqësia e tij më kthen gjithmonë në ato vite rinie në shkollën angleze, në aventurat tona prej musketierësh në rezidencën e Ambasadës së

Meksikës dhe në kujtime të tjera më të largëta apo më të dhembshme. Dhe ndodhi përsëri atje që kam njohur José Donoso, më i moshuar se unë, krenaria e ardhshme e letërsisë kiliane. Nuk di nëse e mban mend. Dhe në një shkollë të mëparshme kam njohur dhembjen e një shoku të ngushtë, vdekur dymbëdhjetë vjeç, duke më lënë të pikëlluar përballë vdekjes së parë të një burri të vogël të moshës sime. Po aq të pikëlluar dhe nga fati i një fëmije tjetër, me të meta trupore, objekt talljesh dhe goditjesh, dhe që unë pata guximin ta mbroj, duke zbuluar kështu një përmasë tjetër të miqësisë: *ndihmesën*. Dhe kur mendoj që të nesërmen e puçit të tmerrshëm ushtarak të Pinoçetit të ndyrë, ky djalë, bërë tashmë një burrë, ka qenë torturuar në kampet e vdekjes në jug të vendit, nuk më shtohet vetëm tmerrri përballë mizorisë së njerëzve, por dhe vetë dashuria dhe ngrohtësia përballë asaj ç'trajtojmë këtu - *miqësisë*.


Sepse të gjithë, në një shkallë apo tjetër, e kemi tradhtuar miqësinë, ose na ka tradhtuar ajo. Grupet gjymtohen, bandat shpërndahen, dhe shokët e ngushtë të rinisë mund të bëhen hijet më të largëta, më të shpërfillura të moshës madhore. Kjo është ngaqë asgjë më tepër sesa miqësia nuk i shkon përshtat tradhtisë. Po ta bënim listën e miqve të humbur, shënimet anash do të shkruanin urretjen, rivalitetin, por edhe epoka të veçanta dhe largësi epike. Ato do ta shkruanin vdekjen. Përse i kemi braktisur? Përse na kanë braktisur? Po ta vrojtosh mirë, ka pak miqësi në botë. Sidomos ndërmjet kolegësh. William Blake e ka thënë këtë në një mënyrë të shkëlqyer: *Miqësia jote më dhemb shumë. Të lutem, ji pra armiku im*. Sepse nëse miqësia, në zanafillë, është gatishmëri, bujari, hapje ndaj tjetrit, ajo nuk mungon së qeni, në të njëjtën kohë, një tejflakje e fshehtë, helmuese, e këtij afrimi të ngushtë, të shikuar si varësi. Kurse Vordsvorth përmend "orët e para" të jetës kur ne provojmë atë kundërshtinë e cila na hedh mbi udhën e fatit por, në të njëjtën kohë, duke u mbrojtur nga të papriturat e tij. Nganjëherë ata bëjnë dhe humor. Kështu, Singer Sargent deklaronte se sa herë që ai bënte një portret, humbiste një mik. Dhe kancelari britanik Caning i jepte miqësisë një rrotullim diplomatik: *Më shpëtoni nga miku i sinqertë*, thoshte ai. Është e qartë, në

*diplomaci dhe në politikë, t'i besosh miqësisë*, kjo mund të çojë në gabim sepse pushteti përqendron ligjet vrasëse të miqësisë. Tradhti. Pendim. Braktisje. Shpërdorimi i besimit mbjell fushën me kufoma. Llogore të braktisura nga moskokëçarja e forcës. Dhe nga tundimi i humorit mizor. Malraux pyet Genet: *Ç'mendoni ju për mua? Genet: Nuk ju dua aq sa t'ju them!*

Këto mësimet nuk janë të kota. Tokat më të djerra lulëzojnë nganjëherë për të na treguar që, në çështje miqësie, duhet të dish të rreshtohesh në mençurinë e klerikut dhe të pranosh që edhe plagët e mikut mund të jenë plagë besnike që ne mund t'i dalim përballë për t'i thënë përse nuk e duam. Kjo është një kënaqësi të cilën nuk duhet t'ia japim kurrë armikut. Por, më e tmerrshmja, në humbjen e miqësisë është zija e atyre ditëve të cilave miku ua dha një kuptim. Të humbasësh një mik, kjo është mirëfilli një humbje kohe. Shpresa të fryra, xhelozia përballë fitores së tjetrit. Është koha për t'u rikthyer te miqësia duke ditur që ajo kërkon përkujdesje të përditshme për të dhënë frytet e saj të mrekullueshme. Për të themeluar simpati, për t'iu gëzuar afrive. Për t'i dhënë pak lumturi njëri-tjetrit. Për t'iu bindur një disiplinë të gëzuar për mbajtjen e lidhjeve. Për të zbuluar me mikun madhështinë e botës dhe kënaqësinë e kalimit të orëve bashkë. Dhe për të qeshur me mikun. Për ta jetuar miqësinë si një ftesë të përhershme për të pranuar, për t'u pranuar. Dhe për të kërkuar në thellësi të vetes mundësinë e një miqësie të përkryer, mënjane çdo cenimi. Për të jetuar në shoqërinë e miqve pa i lënë vend turpër për të nesërmen, pa folur keq për ata që mungojnë. Për ta mbrojtur miqësinë kundër zilive, xhelozive, frikërave. Dhe për të rënë dakord që të mos jemi dakord - *agree to disagree*. Kundërshtitë duhet ta shtojnë miqësinë dhe respektin e ndërsjellë. Një lidhje e zgjuar mes miqsh nuk vuan nga asnjë ambicie, intolerancë apo shpirtngushtësi. Miqësia është një modesti e denjë, është imagjinatë dhe zemërgjerësi.

Dhe nganjëherë, e përse jo? Ajo është krejt e kundërta: Sedër. Pasivitet. Koprraci e ndjenjës.

Nëse dialogu është një nga festat e miqësisë, edhe heshtja mund të jetë e tillë. Kështu që një nga mësimet e miqësisë sime me Luis Buñuel. Në fillim unë mendoja se pauzat gjatë bisedave tona - në përgjithësi



mjaft të ndezura - ishin në njëfarë mënyre për fajin tim si një qortim që ai më bënte. Kam kaluar shumë kohë për të kuptuar që të heshtësh me dikë, kjo ishte për të një formë e lartë e miqësisë. Një respekt. Një nderim. Një refleksion, në të kundërt me llogotitjen e pastër. Sepse ne nuk bëhemi, në çast, papagaj... por ne do të jemi, përnjë çast, filozofë. Tekefundit, dy stoikët, Seneka dhe Manolete, a nuk vinin nga Kordoba?

Kjo përvojë e miqësisë si heshtje refleksioni dhe respekti, më përcjell në atë kufirin e pashmangshëm midis jetës bashkë dhe jetës vetmitare. Sepse nëse miqësia është ajo që i lidh ato, uni duhet t'i kërkojë vetmi asaj. Kjo është e natyrshme. Ne kërkojmë për veten tonë pasionin, zgjuarsinë apo dashurinë që ne e njohim në vështrimin e mikut. Simpatitë, lëvizjet e afrimit, kanë një cak: unin tim. Unë rikthehem te vetja, te braktisja ime, sigurisht, por dhe te vetë pushteti im. E kujtoj me mall fëmijërinë e hershme të ndarë me shokët. Sa e vështirë është t'i mbash këto lidhje në moshë madhore! I rikujtoj çastet e prishjes së tyre, me dhembjen e tyre të pashmangshme. Orët nuk janë më të njëjtat. Udhët janë degëzuar. Por, nuk mund ta refuzoj këtë lëmoshë që uni i kërkon, tekefundit, pasurisë së miqësisë. Sepse, a nuk e dinim ne, në heshtje, që nga fillimi, që një ditë ne do të provojmë


përballë mikut nevojën e përtëritjes së ekzistencës sonë? A nuk e dinim ne që prej kaheerë, me një shqetësim të thellë, me turp ndoshta, që ne ishim mbartës të një papërsosmërie, të një mangësie që ne nuk mundeshim as ta zbulonim e as ta ndanim me mikun më të shtrenjtë?

Atëherë, çuditërisht, ne ia dorëzojmë botës këtë papërsosmëri dhe shoqërisë - turpin tonë, me shpresën që të marrim ndihmë nga një tjetër formë miqësie, ajo e të përkriturit ndaj jetës në përgjithësi. Artisti, nga përkufizimi, mëson shumë shpejt që ta durojë vetminë në emër të veprës së tij. Më përgjithësisht, është vetë miqësia ajo që na detyron jo vetëm t'i njohim caqet tona por, edhe të kuptojmë që ne i kemi të përbashkëta ato. Thoreau thoshte se ka tri karrige për të: *njëra për vetminë, tjetra për miqësinë, e treta për shoqërinë*. Të dish të jesh vetëm, kjo është kundërpesha e domosdoshme, pasuruese, e kohës së ndarë me miqtë.

Vetmia nuk është kundërpesha e vetme e miqësisë. Edhe vdekja gjithashtu është e tillë. Nëse unë kujtohem besnikërisht për shokët e mi të fëmijërisë së hershme, unë kam një mendim krejt të veçantë edhe për të mëdhenjtë, tashmë të ikur, që qenë gjithashtu mësuesit e mi.

Brezi im kujton me një nderim krejt latin, dy figura të mëdha të rinisë sime: meksikanin Alfonso Reyes dhe spanjollin Manuel Pedroso. Dy të urtë që, veç kësaj, ishin miq. Mësimdhënia e tyre intelektuale shkonte bashkë me mësimin e përzemërsisë. Ata s'prisnin, si profetë të rremë adhurim, pa hijen e një kundërshtie. Përkundrazi, ata shpresonin - kërkonin - ripushtimin e rinisë së tyre, në shkëmbim të pushtimit tonë të dijes dhe të përvojës së tyre të gjatë. Me Reyesin e vogël, topolak dhe me Pedroson e madh dhe të bëshëm ne zbulonim që miqësia nënkupton përzgjatjen në mplakje, në kohë. Që gjithmonë mbetet diçka për t'u zbuluar. Që miqësia korret sepse ajo mbillet. Që askush nuk bën miq pa bërë armiq, por që armiku më i keq nuk do ta ketë kurrë peshën e një mikut. Që miqësia është një formë pafjalësie; ajo nuk e pranon shpifjen (që shtrembëron fjalët e atij që flet), dhe as thashethemet të cilat njollosin gjithçka ku prekin. Miqësia është besim (është më turp të mos kesh besim te miqtë sesa t'i mashtrosh ata - shkruante La Roçefoukauld). Miqësia, për ta thënë më shkoqur, na mëson udhën e respektit dhe udhën e një largësie të mençur, gjë që kjo s'e ndalon atë për të dashur apo urryer të njëjtat gjëra.

Kështu, epokat e jetës maten me kutin e afrive që ne i ruajmë dhe i mirëmbajmë. Harrojmë miq tejet të largët. Braktisim miq rinie që nuk janë rritur me të njëjtin ritëm. Kërkojmë miq më të rinj për të gjetur një forcë jetësore e cila, fizikisht, largohet. Ose dhe kërkojmë miq të përhershëm, dhe zbulojmë se ne nuk kemi më asgjë për të thënë. Jemi të pranishëm për degradimin e miqësive të vjetra, që ne nuk i njohim ose nuk na njohin më. Por, kur mosha largohet, kjo është ngaqë ajo na pret. Në muzg shohim të shndrisin dritat e rinisë së hershme. Në mesin e një bryme të largët, ne rigjejmë afritë, rinisemi në kërkim, rizbulojmë rininë tonë, dhe përsëri jemi grup, formojmë rrethin, klanin, bandën, vëllazërinë. Korrim edhe një herë pasionet. Dhe vështrojmë me mall orët e vjetra të miqësisë që largohen njëllor sikur të mos kishin qenë kurrë.



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## 'Art Motion' dhe 'Klan Kosova' fitojnë të drejtën televizive të Superligës

**PRISHTINË, 9 GUSHT (ER)** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe "Art Motion dhe Klan Kosova" kanë vazhduar kontratën e bashkëpunimit për të drejtën e transmetimit të ndeshjeve të Superligës për edicionin 2021/2022.

Duke konstatuar se "Art Motion dhe Klan Kosova" edicionin e kaluar kishte bërë ofertën më të mirë dhe kishte fituar të drejtën e transmetimit për edicionin 2020/2021 dhe mundësinë e vazhdimin të kontratës, komisioni i FFK-së mori vendim për vazhdimin e kontratës të njëjtës kompani edhe për një vit, pasi që ishte oferta më e mirë. "Art Motion dhe Klan Kosova" gjithashtu ka fituar të drejtën e transmetimit edhe të Ligës së Parë për edicionin 2021/2022, si

dhe transmetimin e garave të Kupës së Kosovës. Për të gjitha këto të drejta televizive, FFK dhe "Art Motion e Klan Kosova" kanë kontraktuar në vlerë prej 600 (gjashtëqind) mijë eurosh.

Pas marrjes së vendimit, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka falënderuar kompaninë "Art Motion e Klan Kosova" për bashkëpunimin, njëherësh i ka përgëzuar ata për ofertën e kënaqshme, duke iu uruar suksese.

Siç dihet, FFK-ja të gjitha të hyrat nga e drejta vendore televizive ua shpërndanë klubeve të Superligës së Kosovës dhe Ligës së Parë, me ndarje 450 mijë euro për Superligën për vit futbollistik, si dhe 150 mijë euro për Ligën e Parë po ashtu për vit futbollistik.



## Ambasada e Francës në Kosovë shkruan për Lojërat Olimpikë dhe uron Distrien dhe Norën



**PRISHTINË, 9 GUSHT (ER)** - Kanë përfunduar Lojërat Olimpikë në Tokio të Japonisë. Dorëzimi i flamurit olimpik është bërë të dielën dhe tani atë e mban Franca që është organizatore e olimpiadës së ardhshme. Ambasada e Francës në Kosovë ka shkruar për këtë ngjarje të madhe. Pas tre vjetëve, Franca do të jetë organizatore e Lojërave

Olimpikë Paris 2024.

Ambasada e Francës në Kosovë ka uruar edhe dy xhudistet e Kosovës, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, për medaljet e fituara. "Ceremonia e mbylljes së Lojërave Olimpikë Tokio 2020 u zhvillua të dielën. Urime xhudistëve të Kosovës që fituan dy medalje të arta brilante! Franca, gjithashtu, u dallua me 33 medalje të fituara (10 të arta,

12 të argjenta, 11 të bronzta). Urime ekipit francez! Dorëzimi i flamurit olimpik u bë të dielën dhe tani i takon Francës ta marrë pishtarin me Parisin 2024. Do të jetë hera e tretë që Franca organizon Lojërat Olimpikë Verore në Paris, pas vitit 1900 dhe 1924, pra 100 vjet pas edicionit të fundit parisien të Olimpiadës", ka shkruar Ambasada e Francës në Kosovë.

## Murat Yakin merr drejtimin e përfaqësueses së Zvicrës

**BERN, 9 GUSHT** - Vladimir Petkovic është larguar nga përfaqësuesja e Zvicrës pasi arriti sukses historik, duke e dërguar në çerekfinale të evropianit. Federata e Futbollit e Zvicrës nuk ka humbur shumë kohë dhe ka gjetur zëvendësuesin e tij. Ish-

mbrojtësi legjendar i Zvicrës, Murat Yakin, ka marrë drejtimin e helvetikëve. Yakin ka nënshkruar një kontratë deri në vitin 2022, me mundësi vazhdimi nëse arrin kualifikimin në Kampionatin Botëror 'Katar 2022'. 46-vjeçari është shprehur shumë i lumtur



që është rikthyer në ekipin përfaqësues të Zvicrës. "Jam shumë i lumtur dhe krenar që do të punoj përsëri për ekipin kombëtar. Pritja ime është e madhe. Të dashur tifozë zvicëranë të futbollit, mezi pres t'ju shoh", ka thënë Yakin në një video të shkurtër menjëherë pas

zyrtarizimit. Yakin njihet ndryshe si një trajner i afërt tej mase me futbollistët shqiptarë ku ka punuar si në Grasshoppers apo Schaffhausen. Te përfaqësuesja e Zvicrës Yakin do t'i ketë futbollistët shqiptarë si Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri e Admir Mehmedi.

## Mbahet turneu përkujtimor "Bajram Neziri"

**PRISHTINË, 9 GUSHT (ER)** - Në stadiumin e KF "2 Korriku" në Prishtinë është mbajtur turneu përkujtimor "Bajram Neziri" në shenjë kujtimi për ish-administratorin dhe punëtorin e dalluar të FFK-së. Në këtë turne morën

pjesë katër skuadra të kryeqytetit në grupmoshën e juniorëve: Prishtina, Flamurtari, 2 Korriku dhe Ramiz Sadiku. Fitues i turneut doli KF "2 Korriku" që në finale e mundi KF "Ramiz Sadiku" pas ekzekutimit të

penalltive. Lojtari më i mirë i turneut u shpall Mihtar Avdiu i KF "2 Korriku", ndërsa portieri më i mirë Arnis Ajeti i KF "2 Korriku". Kupat dhe medaljet për më të mirët u ndanë nga familjarët e Bajram Nezirit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 916/1  
Dt: 09.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës (20 orë mësimore)	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Mikrobiologji dhe Imunologji (10 orë mësimore)	Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të:

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## >> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P "Hysni Zajmi" Gjakovë

► Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► "DEPO STEEL" Sh.p.k. me adresë në Bresje -4, Fushë Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: NUI 810545171.

► Fjolla Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi".

► Qëndrim Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi"

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merrret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

